



Republika e Kosovës \* Republic of Kosova

Komuna \* Municipality

Hani i Elezit



Date 14.09.2020

Nr.09/6768/2020

## KONTRATË SHËRBIMI

**KOMUNA HANI I ELEZIT** përfaqësuar nga Zyra e Prokurimit me Zyrtarin Përgjegjës Xhevdet Bushi, MSc. (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

**Hamzi Berisha B.I. (Emri tregtar NT."EURO TURS") nga Fsh.Gorancë - Hani i Elezit** me Numer Unik Identifikues 811355884 me NRB:70644576 NRF 600697009 (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), përfaqësuar nga Hamzi Berisha ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për: "Transporti i nxënësve Hani i Elezit-Kaçanik dhe anasjelltas dhe transporti për pjesëmarrje ne gara dhe aktivitete tjera jashtë shkollore sipas llojeve" me numër Identifikues: **KKHE-20-028-236**  
**Neni 1 Lënda**

**1.1 Lënda e kontratës do të jetë :** "Transporti i nxënësve Hani i Elezit-Kaçanik dhe anasjelltas dhe transporti për pjesëmarrje ne gara dhe aktivitete tjera jashtë shkollore sipas llojeve".

**1.2 Kontrata hynë në fuqi me 14.09.2020 dhe përfundon me 14.08.2021.**

**1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 1 ditë nga data e marrjes së urdhërësës.**

**1.4 Verdi i realizimit të shërbimit do të jete sipas ofertës:**

**Llot-I- Hani i Elezit- Kaçanik dhe anasjelltas**

**Llot-II- Transporti për pjesëmarrje ne gara dhe aktivitete tjera jashtë shkollore**

**1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP<sup>1</sup> (Detyra e Dërguar e Paguar).**

### **Neni 2 Ligji i aplikueshëm**

**2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë** Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

### **Neni 3 Çmimi**

**3.1 Çmimi i kontratës do të jetë për :**

**Hani i Elezit- Kaçanik dhe anasjelltas dhe Transporti për pjesëmarrje ne gara dhe aktivitete tjera jashtë shkollore**

**Llot-I- 5,670.00 (Pesë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë euro /00 cent)**

**Llot-II- 2,885.00 (Dy mijë e tetëqind e tetëdhjetë e pesë euro /00 cent )**

Transporti shkuarje - ardhje respektivisht marrja dhe kthimi i nxënësve do të behet sipas relacioni të paraqitur ne ofertë duke i dërguar tek shkolla ,po ashtu edhe kthimi i nxënësve do të behet duke i marrur nxënësit tek shkolla.

Transporti llogaritet për dite pune (ditë mësimi ) këtu përjashtohen ditët e pushimit,festat etj.

<sup>1</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.2 Për mbarevajtjen e realizimit të shërbimit të transportit ditorë të nxënësve do të kujdeset Drejtoria Komunale e Arsimit respektivisht zyrtari i saj z.Irfan Qajani,-Zyrtar për çështje pedagogjike,i cili do të harton raport mujor, dhe do të na njofton për ecurinë e realizimit të shërbimi.

3.3 Pagesa do të bëhet varësisht nga shërbimi mujor i transportit që të kryhet sipas kalendarit shkollorë dhe sipas angazhimit që do të ketë operatori ekonomik në baze të kërkesës së autoritetit kontraktues respektivisht Drejtorisë Komunale të Arsimit.

3.4 Për shkak të gjendjes epidemiologjike me COVID 19,mund të ndodh që të mos realizohen të gjitha sasitë e planifikuara të shërbimeve të transportit ditorë, prandaj pagesa do të bëhet për atë shërbime sa do të realizohen.

3.5 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës.

Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas brezës përkatëse, nëse aplikohet).

#### **Neni 4                      Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

***Pagesa do të kryhet më së shumti 30 ditë nga data e pranimit të faturës.***

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

#### **Neni 5                      Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

#### **Neni 6                      Kualiteti**

6.1 Kualiteti i Furnizimeve/shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet të kërkuara e të parashtruara në Dosjen e Tenderit. Në rast se të kundërtën nuk do të bëhet **pranimi i furnizimit/shërbimit**.

#### **Neni 7                      Garancioni**

7.1 Ekzekutimi i kontratës do të jetë valid 11 muaj të siguar me sigurim të ekzekutimit të kontratës në 10 % të vlerës së kontratës për periudhë prej 12 muajve nga data e nënshkrimit të kontratës dhe për çdo mos-kryerje të shërbimit sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, dhe do të detyrohemi njëanshëm të bëjmë shkëputjen e kontratës në fjalë dhe të marrim masa ligjore.

#### **Neni 8                      Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin **[t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat]** brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së **[furnizimeve]** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

#### **Neni 9                      Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

#### Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

#### Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

#### Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

#### Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në **Gjykata kompetente** në pajtim me ligjin e Kosovës.



#### Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqipe]<sup>2</sup> në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

|             |                                                                                     |             |                                                                                       |
|-------------|-------------------------------------------------------------------------------------|-------------|---------------------------------------------------------------------------------------|
| Emri:       | Hamzi Berisha                                                                       | Emri:       | Xhevdet Bushi                                                                         |
| Pozita:     | Drejtor                                                                             | Pozita:     | Shef i Zyrës së Prokurimit                                                            |
| Nënshkrimi: |  | Nënshkrimi: |   |
| Data:       | 14.09.2020                                                                          | Data:       | 14.09.2020                                                                            |
| Vula:       |  | Vula:       |  |

<sup>2</sup> Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.